Elbasan, trafik armësh drejt Maqedonisë së Veriut dhe falsifikim dokumentesh, në pranga organizatori dhe dy bashkëpunëtorët

Një 59 vjeçar është arrestuar në Elbasan pasi akuzohet se organizonte trafikimin e armëve drejt RMV-së dhe falsifikimin e dokumenteve. Në pranga kanë rënë dhe dy bashkëpunëtorët e tij.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
5 Mars, 11:30 | **Përditesimi: 5 Mars, 11:38**

Share

ELBASAN - Një 59 vjeçar është arrestuar në Elbasan pasi akuzohet se organizonte trafikimin e armëve drejt Maqedonisë së Veriut dhe falsifikimin e dokumenteve. Në pranga kanë rënë dhe dy bashkëpunëtorët e tij.

Në kuadër të operacionit të koduar "Organizatori" u arrestuan Elban Coniku, Dhimitër Peqini dhe Artan Lila ndërsa janë sekuestruar 3 armë zjarri kallashnikovë, 3320 fishekë luftarakë, një granatë defensive dhe 20 dokumente të dyshuara të falsifikuara

Ky operacion u realizua pas një hetimi 4-mujor nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Seksionit për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Elbasanit.

LEXO EDHE:
Djegia e mbetjeve urbane, Prokuroria e Policia 'zbarkojnë' tek Inceneratori i Elbasanit! Në hetim shoqëria 'Eco-Elb' dhe zyrtarë të Bashkisë, merren në pyetje disa persona (VIDEO)

Si rezultat i operacionit, janë arrestuar shtetasit Dhimitër Peqini, 59 vjeç, banues në Elbasan, i cili akuzohet për organizimin e trafikimit të armëve dhe falsifikimit të dokumenteve, si dhe dy bashkëpunëtorët e tij, Elban Coniku, 52 vjeç, banues në Gramsh, dhe Artan Lila, 47 vjeç, banues në Elbasan.

Gjatë operacionit, në banesën e 47-vjeçarit janë gjetur dhe sekuestruar 20 dokumente të dyshuara të falsifikuara, përfshirë dokumente shqiptare, bullgare dhe maqedonase, si dhe pajisje që shërbenin për falsifikimin e këtyre dokumenteve. Po ashtu, gjatë një kontrolli në fshatin Çekin, Gramsh, janë sekuestruar 3 armë zjarri kallashnikovë, 3320 fishekë dhe një granatë që do të trafikonin drejt Maqedonisë së Veriut, informoi sot policia e Elbasanit

Hetimet vazhdojnë për të identifikuar dhe ndaluar shtetas të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal.

S.G/r.k./Shqiptarja.com

TAG: trafik armesh | Elban Coniku | Artan Lila | Dhimitër Peqini | Elbasan | Maqedoni e Veriut

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 6 Mars, 14:52
Si ju duket vendimi i qeverisë për të mbyllur me një vit Tik Tok?
I drejtë | I gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Një nga ne/ Jeta plot vuajtje e Kostandin Qoses: Lashë gërnetën se më vdiq djali, pensioni nuk del, punoj kovaç në Tregan
Xhensila Nako
5 Mars, 20:28

Elbasan/ Makina përfshihet nga flakët në qendër të qytetit, nuk dihen shkaqet (VIDEO)
5 Mars, 12:03

Elbasani në krizë për mbetjet, s'ka hapësirë te inceneratori! Këshilli rrëzon projektin e bashkisë për landifillin e ri
Ronaldo Gjoshi
4 Mars, 18:06

Elbasan/ Nuk iu bind policisë për të ndaluar mjetin me të cilin shpërndante kokainë, arrestohet 30-vjeçari në Peqin
4 Mars, 11:33

Veri-Jug/ Karina, fshati i pemëve në lulëzim! Fermeri: Frutat i eksportojmë drejt Kosovës
2 Mars, 17:03



Temperaturë, të vjella e diarre urgjenca plot në Librazhd! Mjeku: Më të prekur fëmijët, mos merrni mjekim pa recetë
Ronaldo Gjoshi
2 Mars, 16:39

Primaret e PD/ Dashnor Sula më i votuari në qarkun e Elbasanit, Lefter Gështenja renditet i shtati
2 Mars, 13:11

Gramsh/ Vodhën para dhe sende me vlerë në dy banesa, arrestohen 3 të rinjtë
2 Mars, 10:05

Aksident tragjik në aksin 'Elbasan-Peqin', vdesin nënë e bir, 5 të plagosur në spital (VIDEO)
2 Mars, 08:59

Primaret e Partisë Demokratike/ Nis votimi në qarqet e vendit për të zgjedhur kandidatët në lista
1 Mars, 09:07

Aksident në aksin 'Elbasan- Metalurgji', dy makina përplasen me njëra-tjetrën, plagosen 3 persona
28 Shkurt, 22:56

SPAK godet sërish organizatën kriminale të Çopjave, u sekuestrohet një vilë në Elbasan
26 Shkurt, 13:19

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje